

REPUBLICA E KOSOVES-VLADA / REPUBLIKA E KOSOVES-VLADA
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE INOVACIONIT
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND INNOVATION
 SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org. 5
 Org. Jedinica 5
 Org. Unit 5
 Nr. i faqeve 2
 Br. stranica 2
 No. pages 2

Nr. Prot. 1833
 Broj Prot. 1833
 Prot. No. 1833
 Data: 12.10.22
 Datum: 12.10.22

Prishtinë / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 12-10-2022
 Nr. 5/1833

Komisioni për Licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 50 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Republikën e Kosovës si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, mori këtë :

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi me nr. prot.1833 i datës 12.10.2022.
2. Pika 2 e vendimit ku bëhet fjalë, citojmë: Licencohet.....dega në Prizren dhe Ferizaj – emri i qytetit Ferizaj hiqet dhe zëvendësohet me emrin e qytetit Pejë. Pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjta.
3. Pika 3 dhe 5 e vendimit nr.prot. 1833 i datës 12.10.2022 hiqen krejtësisht duke konsideruar që pikat 1, 2 dhe 4 të këtij vendimi e plotësojnë dhe i japin formë të plotë ligjore veprimtarisë së institucionit për të cilin është lëshuar ky vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për Licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1833 i datës 21.07.2022, të parashtruar nga Kolegji “UBT”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim në nivel institucional dhe të programeve duke u mbështetur në vendimet e KSHC-së të shënuara në dispozitivin e këtij vendimi.

Licenca në nivel institucional e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025) sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim/ KSHC-së.

Licencohet në nivel institucional, BPrAL - Kolegji “UBT” dega në Prizren dhe Pejë sipas vendimit nr. 980/20D i datës 21.07.2020 për periudhën kohore nga 1 tetori 2020 deri me 30 shtator 2023.

Ndërkaq, kohëzgjatjet e licencimit në nivel të programeve bazohen sipas vendimeve të AKA / KSHC-së, të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e paraqitura në dokumentacionin për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. BPrAL- Kolegjit “UBT”
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Komisionit për licencim;
4. DALSHT;
5. Qendrës NARIC;
6. Inspektoratit të Arsimit;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit


Burim Gashi